

# **Nga data 1<sup>o</sup> shkurt, duhet të keni kartën Jeshile “bazë” (green pass) "base", për të hyrë në zyrat e komunës**

Në përputhje me D.L. n. 1, të datës 7.01.2022 nga data 1 Shkurt 2022 dhe deri në datën 31 mars 2022 **u lejohet hyrja në zyrat e Komunës, vetëm atyre personave që janë të paisur me të ashtuquajturën Green Passi “bazë”, pra çertifikata e gjelbër COVID-19, që dëshmon një nga kushtet e mëposhtme:**

- që keni kryer vaksinimi kundër SARS-CoV-2, jeni në fund të ciklit të parë të vaksinimit ose që keni bërë edhe dozën e dytë përforcuese të këshilluar;
- që jeni shëruar nga COVID-19, keni mbaruar izolimin e detyrueshëm si pasojë e infektimit me SARS-CoV-2, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Udhëzuesi i Ministrisë së Shëndetësisë;
- që jeni të paisur me një test antigjenik të shpejtë apo molekular, ky i fundit edhe nga kampioni i pështymës me rezultat negativ për virusin SARS-CoV-2, ashtu si përcaktohet nga kriteret e Udhëzuesit të Ministrisë së Shëndetësisë;
- që jeni shëruar nga COVID-19 pas kryerjes të dozës së parë të vaksinës apo që jeni në përfundim të ciklit të parë të vaksinimit, ose që keni bërë edhe dozën e dytë përforcuese të këshilluar;